

- 32 -

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 1 Date 11.06.2010

“PER
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TE POSACEM
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne piken 9, kreu XI, “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”, i vendimit nr. 87, dt. 16.01.2008 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, dhe nenit 18 germa dh, te ligjit nr.8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

- 1- MIRATIMIN e Autorizimit te posacem per Perdorim te Rezerves Ujore, Lumi “Zalli Okshtunit” (Dege e Drinit te Zi) , se bashku me deget e tij, komunat Ostren, Zerqan, Gjorice, Qarku Diber, per HEC Borove, HEC Zabzun, HEC Sebishte, HEC Prodan 1, HEC Prodan 2, HEC Okshtun, HEC Okshtun Ekologjik, HEC Ternove, HEC Lubalesh 1, HEC Lubalesh 2, HEC Gjorice. Nga kuota maksimale e rrjedhes + 1010 metra deri ne kuoten minimale te rrjedhes + 490 metra, per prodhim hidroenergjie, Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive “ 2 T” Sh.P.K., “PERXHOLA” SH.P.K. “ALBADI” SH.P.K., “ME-AJ” SH.P.K., “MIXTECNIC” SH.P.K. dhe “ UDSA” SH.P.K., te cilat kane nenshkruar Kontraten e Koncesionit me autoritetin kontraktues me date 03 Qershor 2009, bazuar ne miratimin e marre me V.K.M. nr. 701 dt. 11.06.2009, mbasi shoqeria ka depozituar ne A.U.B. Drin-Bune kerkesen dhe kopjen e Kontrates se Koncesionit per HEC-et qe do te ndertoje.
- 2- Perdorimi i rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PERGJEGJESI I A.U.B.

DRIN-BUNE
Xhelal BAJRAKTARI



KRYETARI I K.B.U.

DRIN-BUNE
Maxhid CUNGU

